



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E JUNIKUT
OPŠTINA JUNIK/ MUNICIPALITY OF JUNIK



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA JUNIK/ OPŠTINA JUNIK/ MUNICIPALITY OF JUNIK	
02/Nr. Prot.	9-189/5273
Nr. i faq.	15
Data	05/07/2022

PLAN I

Emergjent dhe reagimit për ndërtesën e Kuvendit Komunal Junik



Maj 2022

Komandanti i NJPZSH-së Junik
SHKELZEN SHEHU

Përmbajtja e Planit të vlerësimit dhe reagimit

1. Parathënie,
2. Qëllimi i Planit,
3. Ndërtesa administrative
4. Kufizimi i ndërtesës,
5. Rrugët për intervenim,
6. Rrezikshmëria në makro-lokacion,
7. Mundësitë e rrezikut të mbrendshëm.
8. Zona seizmologjike,
9. Klima,
10. Hyrjet në ndërtesën e Kuvendit Komunal
11. Daljet emergjente
12. Demografia-numri i punëtorëve
13. Llojet e aksidenteve
14. Struktura organizative e emergjencave:
 - a/ Komiteti për Menaxhim të emergjencave,
 - b/ Detyrat dhe roli i Komitetit,
 - c/ Posti Komandues,
 - d/ Personeli i Postit Komandues,
 - e/ Identifikimi i Postit Komandues,
 - f/ Detyra dhe roli i Komandantit të Incidentit,
 - g/ Detyra dhe roli i zyrtarëve për intervenime emergjente
 - Zyrtari për zjarrfikje dhe shpëtim,
 - Zyrtari për evakuim,
 - Zyrtari për Sigurim,
 - Zyrtari për ndihmë të parë medicinale,
 - Zyrtari për intervenime teknike,
 - Përgjegjësit e kateve
 - h/ Roli dhe detyra e ekipeve për intervenim emergjent
 - Ekipi për zjarrfikje dhe shpëtim,
 - Ekipi për evakuim,
 - Ekipi për Sigurim,
 - Ekipi për ndihmë të parë medicinale,
 - Ekipi për intervenime teknike,
15. Aktivizimi i Planit të Reagimit,
 - a/ Pasqyra e zyrtarëve dhe ekipeve emergjente,pajisjet,procedurat dhe udhëzimet e veprimit
 - Ekipi për zjarrfikje dhe shpëtim,(paisja,procedurat
 - Ekipi për evakuim,(paisja,procedurat,udhëzimi)
 - Ekipi për Sigurim, (paisja,procedurat,udhëzimi)
 - Ekipi për ndihmë të parë medicinale,(paisjet,udhëzimi)
 - Ekipi për intervenime teknike, (paisjet,udhëzimi)
 - Përgjegjësit e kateve
16. Trajnimi,
17. Përfundimi

Parathënie

Plani i Reagimit për ndërtesën e Kuvendit të Komunës së Junikut është hartuar në bazë të "Ligjit për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, Ligjit për Mbrojtje nga zjarri, draft-rregulloreve, përvojave paraprake, ligjëratave, seminarëve dhe materialeve në kuadër të bashkëpunimit me agjensionin e Menaxhimit të Emergjencave të mbajtura si dhe shkëmbimit të përvojave profesionale.

Qëllimi i Planit

Qëllimi i hartimit të këtij Plani është krijimi i prioritetëve për një koordinim sa më efikas në mes të subjekteve relevante të cilat janë përgjegjëse që të veprojnë shpejtë dhe profesionalisht në rastet e fatkeqësive-aksidentëve në objektë-ndërtesë, si dhe koordinimi e ekipeve emergjente me strukturat jashtë Kuvendit apo edhe në koordinim me emergjencat në nivel të Kosovës.

Ndërtesa administrative ,makro-lokacioni dhe Karakteristikat e ndërtesës:

Objekti gjendet në qendër të qytetit përkatësisht në "Sheshi Edmond Hoxha" afër "Në Qendër të Junikut, Objekti është ndërtuar në teren të rrafshët në vitin 2010 Objekti nuk ka anekse dhe përbëhet prej një kompleksi me dimensione 1758m² i ndarë në P₂ katë dhe secili pozicion ka rreth 51 **punëtorë**, dhe ka këtë hapësirë përcjellëse:

- gjelbërim përpara ndërtesës dhe hyrja 890 m².
- parking për automjete 650 m².
- oborr prapa objektit 230 m².

Kufizimi i ndërtesës së Kuvendit komunal:

- Nga ana lindore kufizohet arë (livadh)
- Nga ana përendimore me rrugën kryesore të qytetit
- Nga ana jugore me rrugën me posten
- Nga ana veriore me shtëpi private

Rrugët intervenimit-qasjet për ekipet emergjente të qytetit:

Deri tek ndërtesa e Komunës ekipet intervenive për situata emergjente mund të vijnë përmes rrugës kryesore Në qendër nga pjesa veri-përendimore dhe asaj jug-përendimore

KK-Junik kanë arterie të sigurta për të mbërritur në ndërtesën e Kuvendit, dhe pasi që objekti gjendet në qendër të qytetit **mbrenda 5 min.** mund të arrijnë të gjitha ekipet relevante emergjente si: Zjarrëfiksat, Policia, shërbimet medikale

Rrezikshmëria në makro-lokacion:

Në afërsi të vetë objektit nuk ekziston ndojnë objektë i cili në punën dhe veprimtarinë e saj përdor materiale agresive siç janë: nafta benzina, gaz, etj. Parkingu, oborri dhe hapsira rrethë ndërtesës si dhe mosprania e objekteve tjera me rrezikshmëri të lartë bënë që ky objekt të jetë relativisht i sigurtë nga ndikimet e mikro-lokacionit rrethë tij.

Mundësitë e rrezikut të mbrendshëm:

Në bazë të vlerësimeve vetanake, ndërtesa Komunes më tepër është e rrezikuar nga faktorët e mbrendshëm se sa nga faktorët tjerë rrethë tij. Rreziku për puntorët, palët që në momentin e aksidentit mund të gjenden në ndërtesë si dhe për vetë objektin dhe pajisjet e dokumentacionin përkatës mund të vjen si pasojë e:

- instalimit elektrik
- mbingarkesës në rrymë elektrike,
- eksplozimit të gjeneratorëve në afërsi të ndërtesës,
- mundësia e eksplozimit të rezervuarit të mazutit për ngrohje qendrore me të cilin disponon kuvendi,
- mundësia e eksplozimit të ndojnë automjeti në parking si dhe
- aksidentet e shkaktuara nga vetë puntorët si psh.: pakujdesia në çkyqjen e aparateve elektrike, bombolave të gazit, pajisjeve teknike, kompjuter, kablo elektrike etj.

Zona seizmologjike:

Hapësira në të cilën gjendet qyteti i Junikut dhe vetë objekti i Kuvendit i takon zonës së V të trysnisë (goditjes seismike) në bazë të shkallës së "MSC".

Klima:

- Temperatura mesatare vjetore rrethë 16 gradë C, me ekstreme gjatë dimërit deri në -20 C, ndërsa gjatë verës deri në +38 C,

- Erërat dominante në teritorin e komunës së Junikut janë nga veriu dhe ato veri-lindore dhe jugu, të cilat kanë forcë mesatare 2.6-2.7 "Bofor" dhe shpejtësi prej 3.6-3.8 m/sec.,

- Dominimi i lartë i këtyre erërave në komunën tonë vërehet në periudhën janar-prill,

- Duke llogaritur lartësinë e objektit e cila është __ m si dhe zonën klimatike III të komunës së Junikut, ndërtesa administrative e KK-Junikut i ekspozohet shtypjes së erërave përafërsisht 100 kpa/m².

Hyrjet në ndërtesën administrative

- Ndërtesa administrative të kuvendit të komunës së Junikut ka tri hyrje-dalje kryesore një e ka përball me rrugën Kryesore ku hynë qytetarët dhe tjetra nga parkingu ku hynë zyrtarët dhe daljen emergjente në katin e III.

Përrreth ambientit është i vëzhguar me pajisje elektronike.

Daljet emergjente nga ndërtesa e Kuvendit:

-Në ndërtesën e Kuvendit të Komunës së Junikut ka dalje për situata emergjente,dhe në rast të fatkeqësive-aksidenteve eventuale, ekzistojnë shkallët ndihmëse në rast të evakuimit të personelit dhe palëve të cilët gjenden në ndërtesë në atë moment,

- Në rast zjarrit apo fatkeqësive-aksidenteve të vihet rendi dhe kontrola me rastin e evakuimit si dhe përkujdesja për mos-shkaktimin e panikut, dezinformimit dhe dukurive tjera të keqpërdorimeve.

Demografia-Numri i personelit të punësuar në ndërtesën

Nr.	Pozicioni-etazhi	Numri i personelit	Hapsira në m2
1.	Përdhesa	20	728
2.	Kati I	21	728
3.	Kati II	10	302
4.	Gjithsejtë personel	51	1758

Vërejtje: përveç personelit prej 51 veta mund të jenë edhe rreth 20 palë mesatarisht me punë të ndryshme në ndërtesën e Kuvendit

Shtojca nr.I: lista emërore e personelit sipas kateve dhe zyreve.

Aksidentet dhe fatkeqësit teknologjike:


- a/ Zjarret,
- b/ Eksplozimet,
- c/ Kontaminimi kimik,
- d/ Rrezatimi,
- e/ Avarit në teknikë dhe pajisje,
- f/ Aksidentet në vendin e punës.

Rreziqet e shkaktuara nga dukurit shoqërore:

- a/ Rrezikimi i i ndërtesës nga trazirat në vend,
- b/ Demonstratat,
- c/ Grevat,
- d/ Kurdisja e mjeteve shpërthyes dhe eksplozive,
- e/ Kurdisja e mjeteve kimike-biologjike,
- f/ Sulmi terrorist.

Këtu mbaron pjesa e parë (vlerësimi)1.

2. STRUKTURA ORGANIZATIVE NË DHE VIJA REAGIMIT DHE PËRGJEGJËSIVE NË SITUATA EMERGJENTE:



Përbërja e shtabit emergjentë në ndërtesën e Kuvendit ose institucion:

1. Kryetari i Komunës Ruzhdi Shehu
2. Nënkryetari i Komunës Beasrt Tofaj
3. Drejtori i Shërbimeve Publike inspeksion Mbrojtje dhe Shpetim, z.Demokrat Ganijaj
4. Zyrtari për media z. Arton Gaxherri
5. Drejtori Administratës znj. Leonora Shehu
6. Drejtoria Shëndetsisë dhe Mirëqenies Sociale z. Fatos Shala
7. Drejtoria Urbanizëm dhe Katastër z. Zenun Shala
8. Drejtoria për Kulturë Rini, dhe Sport z. Xhavit Veliaj
9. Drejtoria për Zhvillim Ekonomik znj. Gentiana Tofaj
10. Komandanti NJPZSH-së z.Shkelzen Shehu

Drejtorja Shërbimeve Publike, Inpeksion dhe emergjencave, propozon anëtarët e Komitetit dhe zëvendësimet eventuale të tyre, gjithashtu janë kompetentë për formimin e ekipeve Të intervenimeve, për përgjegjësit e kateve përgjegjësit e ekipeve etj.

Detyrat dhe roli shtabit:

- emëron komandantin e incidentit dhe merrë informata dhe të dhëna tjera për situatën,
- në rast të aksidentit aktivizon Planin e reagimit,
- duhet të jetë i gatshëm që të veprojnë urgjentisht,

- vendos për kahjet dhe metodat e veprimit në gjenerale dhe vendos kontakte me subjektet relevante të komunës apo Qeverisë,
- mban kontakte me media për dhënien e infomatave përmes zyrtarit për media.

Posti komandues:

- Operon në vendin e incidentit,
- Koordinon ekipet e ndryshme në vendin e aksidentit,
- Bënë ndërlidhjen në mes të ekipeve emergjente të kuvendit me strukturat tjera emergjente komunale

Personeli i postit komandues:

- Komandanti i incidentit - kryetari komunës (mundet të caktoj edhe një person tjetër)
- Zyrtari i mbrojtjes nga zjarri,
- Zyrtari i sigurimit fizik dhe teknik,
- Zyrtari për ndihmë të parë medicinale,
- Zyrtari për mirëmbajtje dhe teknikë.

Identifikimi i postit komandues:

- Komandanti i incidentit është i pajisur me helmet të bardhë,
- Zyrtari i mbrojtjes nga zjarri me helmet të kuqe,
- Zyrtari për sigurim me helmet të kaltër,
- Zyrtari për ndihmë të parë medicinale me helmet të gjelbër,
- Zyrtari për intervenime teknike me helmet të zezë ose portokalli

A/ Detyrat dhe përgjegjësitë e Komandantit të Incidentit (KI):

- Vepron në vend të ngjarjes apo në afërsi të tij,
- Koordinon ekipet emergjente në vend të ngjarjes,
- Si shef i postit-komandues së bashku me udhëheqësit e ekipeve drejton të gjitha veprimet në rast aksidenti,
- Është në kontakt të përhershëm me Komitetin emergjent dhe zyrtarët e ekipeve intervenuese,
- Në koordinim me udhëheqësit e ekipeve siguron që detyrat e të jenë të vendosura sipas prioriteteve dhe përkujdeset që ato detyra të jenë të realizueshme,
- Në mungesë të Komandantit të incidentit, udhëheqja i besohet njërit prej zyrtarëve të ekipeve emergjente,
- Komunikimet ndërmjet KI, zyrtarëve të ekipeve emergjente dhe komitetit emergjent mund të jenë gojore, fytyrë-fytyrë, përmes radiolidhjeve, telefonave, celularëve etj.

B/ Detvrat dhe përgjegjësitë e zyrtarëve për intervenim

Emergjent:

1. Zyrtari për Zjarrëfikje dhe shpëtim

- Roli i tij është që të koordinon ekipin për zjarrëfikje dhe së bashku me zyrtarin e ekipit për intervenime teknike koordinon punët në shurjen e zjarrit,
- Merr detyra nga KI dhe i drejton ato,
- Kontrollon mjetet mbrojtëse nga zjarri

2. Zyrtari për evakuim

- merr detyra të caktuara nga Komandanti i incidentit dhe i drejton ato,
- të jetë i njohur detalisht me hapsirën punuese, të koordinoj evakuimin së bashku me përgjegjësit e çdo kati. Në bashkëpunim me postin komandues vendos për shkallën e evakuimit I, II, III,
- të ketë të dhënat për gjithë përgjegjësit e kateve,
- të ketë të caktuar vendin e posaçëm për mbledhjen e personave të evakuuar jashtë ndërtesës, si dhe listat e emrave të personave në çdo kat,
- të siguroj që i tërë personeli të jetë i njohtuar me procedurat e evakuimit, rrugët, daljet më të afërta dhe pikat e grumbullimit.

3. Zyrtari për siguri

- Roli i tij është që të koordinoj me ekipin e sigurimit ,të siguroj hyrje-daljet në ndërtesë dhe nga ndërtesa,
- Merr detyra nga KI dhe i drejton ato,
- Bënë sigurimin-kontrollën e vendit të aksidentit,
- Siguron mbledhjen e informatave me interes për situatën,
- Siguron thesarin dhe dokumentacionin e rëndësishëm në ndërtesë,
- Siguron pikat strategjike të objektit të KK-së dhe për rreth.

4. Zyrtari për ndihmë të parë medicinale

- Merr detyra nga KI dhe i drejton ato,
- Koordinon ekipin e ndihmës së parë në situata emergjente,
- Siguron mjetet e duhura për dhënjene ndihmës së parë,
- Siguron vendin për personat e lënduar dhe hendikep.
- Të siguroj që i tërë personeli të jetë i aftësuar me procedurat e dhënjes së ndihmës së parë medicinale

5. Përgjegjësit e kateve

- duhet të dijnë në çdo kohë numrin e puntorëve për kate,
- Të kenë njohuri dhe të jenë të njohtuar me sist.alarmimit,
- Të kenë njohuri për daljet dhe të gjitha koridoret,
- Të kenë njohura me procedurat e evakuimit

C/ Ekipet e reagimit emergjent në ndërtesën e KK ose institucion:

1. Ekipi për Zjarrëfikje dhe shpëtim

- Bënë shuarjen e zjarrit dhe realizon detyra tjera në rast zjarri,
- Bënë sigurimin e hyrjes së shpëtimtarëve në lokacionet e mbyllura dhe të tymosura,
- Realizon misione shpëtuese lidhur me aksidentet dhe fatkeqësit tjera natyrore,
- Kryen veprime shpëtimi dhe intervenimi me rastin e eksplozimeve, rrejdhet e materieve të rrezikshme, rrjedhjet e gazit, vajërave, vërshimet, shirat, bora e madhe, fortuna etj.

2. Ekipi për evakuim

- Fillon me evakuimin në rast se situata e kërkon,
- Koordinon evakuimin e personelit dhe palëve nga ndërtesa së bashku me përgjegjësit e kateve në drejtim të daljeve të afërta dhe alternative të ndërtesës,
- Bënë kontrollimin e zonës se a janë evakuuar të gjithë të rrezikuarit në ndërtesë,
- Përkujdeset për evakuim të rrjedhshëm dhe me rend duke i ndihmuar punëtorët dhe palët e moshuara dhe me aftësi fizike të kufizuara,
- Të implementoj parimet e emergjencës deri tek pika e jashtme e objektit.

3. Ekipi i sigurimit

- Të siguroj hyrje-daljet,
- Të siguroj vendin e incidentit,
- Të siguroj lëvizjen e lirë në vend të ngjarjes apo rrethë tij
- Siguron rrugët intervente për ekipet emergjente të qytetit në mikro-lokacion,
- Ndalon hyrjen e personave të paautorizuar dhe të painformuar në zonën e incidentit,
- Siguron mbledhjen e informatave,
- Siguron thesarin në ndërtesë dhe dokumentacionin me vlerë,
- Siguron pikat strategjike të objektit.

4. Ekipi për dhënjën e ndihmës së parë medicinale

- Siguron dhe rregullon ambientin për ofrimin e ndihmës së parë medicinale,
- Ofron dhënjën e ndihmës së parë personave të lënduar,
- Bënë trijzhimin dhe siguron transportimin e të lënduarëve të cilët kanë nevojë për tretman special medicinal në qendrën spitalore,
- Përpiqen që të zvoglojnë dhëmbjen dhe të minimizoj pasojat e lëndimeve përderisa të vijnë ekipet profesionale.

5. Ekipi për intervenime teknike

- Menaxhon pjesën energjetike (ndal dhe lëshon rrymën elektrike) në situata emergjente,
- Ndalon punën e elevatorëve, të klimatizimit dhe ngrohjes,
- Ndërmerr aksione intervente në avari makinerie, shpërthimit të ujërave në ndërtesë,
- Në bashkëpunim me ekipin për zjarrëfikje ndërmarrin misione intervenue në rrjedhat e materieve të rrezikshme, rrjedhat e vajërave, në elevator, me rastin e vërshimeve dhe borës së tepërt, në eliminimin e pengesave të konstrukcionit metalik dhe të drurit etj.

3.AKTIVIZIMI I PLANIT TË REAGIMIT NË NDËRTESEN E KUVENDIT

Çdo fatkeqësi-incident krijon nevojën për fillimin e veprimeve të ndryshme operacionale për shpëtimin e jetërave të njerëzve dhe të pasurisë, si dhe veprime tjera në stabilizimin e situatës. Reagimi i tillë përfshin marrjen e lajmit për aksidentin nga punëtorët, paralajmërimin e personelit për menaxhimin e aksidentit, paralajmërimin dhe evakuimin e personelit dhe palëve, shpëtimin e individëve, dhënja e ndihmës së parë për personat e lënduar, mbajtjen e rendit në objekt si dhe kërkimin e ndihmës jashtë objektit.

Aktivizimi i bëhet me marrjen e alarmit për emergjencë nga punëtorët apo individët tjerë. Pas orarit të punës lajmërohet QAKE-112.

Pasqyra e zyrtarëve dhe ekipeve për reagim emergjent në ndërtesë:

1. Ekipi për zjarrëfikje dhe shpëtim
Zyrtari për zjarrëfikje dhe shpëtim:

Nr.	Emri dhe mbiemri	Nr.tel.fiks	Nr.celularit
1.	Qendrim Knushi		044270865
2.	Turim Ganiaj		049760230

Pajisjet e nevojshme-uniforma:

- Hidrant të mbrendshëm 2, hidrant të jashtëm 2 duhet të vendosen në të ardhmen.
- Aparat për fikjen e zjarrit fillestar "S" – 6 Kg..... copë,
- Aparat për fikjen e zjarrit fillestar "S" –10 Kg..... copë,
- Aparat për fikjen e zjarrit fillestar "CO-2" -5 Kg..... copë,

- Aparat për fikjen e zjarrit fillestar "CO-2" -10Kg..... copë,
- Aparat për fikjen e zjarrit fillestar « Hall » 6Kg..... copë,
- Helmeta..... copë,
- Rripa për zjarrfikës të kompletuar..... copë,
- Maska mbrojtëse MC-1..... copë,
- Aparate të izoluar për frymëmarrje »AURER «..... copë,
- Bateri dore..... copë,
- Litar për shpëtim 20mxØ30 mm..... copë,
- Tyta speciale për fikjen e zjarrit..... copë,
- Pompa për thithjen e ujit..... copë,
- Komplet rroba dhe mbathje izoluese të gomës për përballimin e materieve të rrezikshme..... palë,
- Radiolidhje për komunikim të brendshëm..... copë

Përkujtues mbi procedurat në rast zjarri (vlenë për të gjithë puntorët):

- Në rastë zjarri menjëherë lajmëro zyrën alarmuese(kujdestarinë),
- Me të dëgjuar alarmin paralajmëro personat përrethë,
- Tento ta fikësh zjarrin pa rrezikuar vetëvehten,
- Në rast se mundeni mbyllni dyertë dhe dritaret për të penguar përhapjen e tij,
- Ndërpreni veprimin dhe ç'kyqni pajisjet e punës dhe furnizimin energjetik të tyre pa rrezikuar vehten,
- Mos bëjë panik,
- Merri gjësendet personale,
- Ndihmoj personat përrethë me aftësi të kufizuara,
- Mos përdor elevatorin,
- Largohu i qetë duke ecuar deri të dalja a afërtë,
- Të gjinden rrugë alternative dalëse pasi që nuk ka shkallë ndihmëse

Obligimet e secilit në rast zjarri:

- Çdo punëtorë që vëren zjarrin është i obliguar t'i përvishet punës në fikjen e tij,
- Nëse vëren rrezikun i cili drejtpërsëdrejti kërcënon me shpërthim është i obliguar që të eliminon rrezikun dhe shkaktarin,
- Në rast se punëtori nuk është në gjendje të largoj rrezikun apo shkaktarin ,është i obligohet që menjëherë të alarmon kujdestarin (Zyrën e alarmimit),alarmon personelin,
- Përveç ekipeve të zjarrfikësve dhe shpëtimit të gjithë punëtorët e aftë fizikisht janë të obliguar të marrin pjesë në fikjen e zjarrit, nëse Komandanti i Incidentit nuk e kufizon,
- Punëtorët të cilët nuk marrin pjesë në fikjen e zjarrit dhe misione të shpëtimit janë të obliguar që në rrugë sa më të shkurtë ,pa penguar aksionin e fikjes dhe shpëtimit, të evakohen nga ndërtesa e rrezikuar.
- Në të njëjtën kohë është i obliguar të lajmërojnë njësinë e zjarrfikësve të qytetit për ndihmë.
- Me arritjen e njësisë së Zjarrfikësve KI njofton Komandantin e Zjarrfikësve me lokacionin-vendin e shpërthimit të zjarrit si dhe jep të dhëna tjera për fikje dhe shpëtim (afërsia e instalimeve ,trafo, hidrantëve etj),

- Pas informimit të komandantit të njësisë së Zjarrfikësve, KI ia dorëzon kompetencat komandantit të njësisë së qytetit dhe gjithnjë i qëndron atij afër për të dhënë informacione shtesë,
- Pas aksionit të lokalizimit dhe fikjes së zjarrit duhet pasur parasysh kujdesin për ruajtjen gjurmëve të shkaktarëve të zjarrit

2. Ekipi për evakuim

Zyrtari për evakuim:

Nr.	Emri dhe mbiemri	Nr.tel.fiks	Nr.celularit
1.	Zeqë Hebibi		049241500
2.	Arton krasniqi		049760285

Pajisjet e nevojshme:

- Uniforma të thjeshta me ngjyrë të kaltër..... palë
- Maska mbrojtëse MC-1.....copë
- Helmeta copë
- Radiolidhje për komunikim..... copë
- Bateri dore për ndriçim..... copë
- Litar për shpëtim 20mxØ30 mm..... copë,

Përkujtues mbi procedurat në rast të evakuimit (vlenë për të gjithë puntorët):

- Në rast të çdo incidenti menjëherë lajmëro zyrën alarmuese(kujdestarinë),
- Me të dëgjuar alarmin paralajmëro personat për-rreth,
- Mbyllë dyertë dhe dritaret e hapësirës punuese,
- Mos bëjë panik
- Ndërpreni veprimin dhe ç'kyqni pajisjet e punës dhe furnizimin energjetik të tyre pa rrezikuar vehten
- Merrë pajisjet personale,
- Mos vrapo,
- Ndihmo personat për rreth me aftësi të kufizuara,
- Largohu i qetë deri tek dalja më e afërt,
- Dëgjo urdhërat e përgjegjësit të katit,
- Me të arritur jashtë objektit rreshtohu në zonën grumbulluese,
- Informo zyrtarin për evakuim për personat e mbetur në ndërtesë apo lokacion,
- Në rast se jeni në grackë në katin e parë dil nga dritarja,
- Në rast se jeni në grackë në katet e larta lajmërohu në dritare dhe prit deri sa të të evakujnë njësit e zjarrfikësve.
- Rri në zonën e grumbullimit deri sa të kalon rreziku,
- Mos hy në ndërtesë pa urdhëresë të personave kompetentë.

Rrjedha e evakuimit:

- Ndërtesa administrative i posedon shkallët anësore për evakuim emergjent, ato janë të kontrukcionit të metaltë çështja e evakuimit në këtë ndërtesë nuk është e komplikuar kati tretë dhe dytë, evakuohen në ndalje ku janë shkallët emergjente.
- Personat në katët e ulëta kanë mundësi më të shumta për zgjedhjen e drejtimit të evakuimit,
- Për evakuim të suksesshëm-të sigurtë prioritet duhet dhënë evakuimit të puntorëve në katet e larta duke koncentruar në masë më të madhe mjetet,pajisjet dhe potencialin njerëzorë për evakuim dhe shpëtim,
- Evakuimi duhet të zbatohet nga ekipi i evakuimit në koordinim me përgjegjesit e kateve i cili ka për obligim caktimin e kahjeve të lëvizjes ,daljet dhe dyert duhet të jenë të hapura dhe që ndërtesa të ketë sistem alarmues për lajmërimin e rrezikut,
- KI koordinon veprimet e ekipeve të evakuimit dhe në konsultim me Komitetin emergjent kërkon ndihmë nga subjektet emergjente të qytetit

3. Ekipi për sigurim Zyrtari për siguri:

Nr.	Emri dhe mbiemri	Nr.tel.fiks	Nr.celularit
1.	Avdyl Maloku		049760262
2.	Ali Gacaferi		044997169
3.			

Pajisjet e nevojshme:

- Uniforma me ngjyrë të kaltër.....5+1 palë
- Maska mbrojtëse MC-1.....5+1 copë
- Helmeta5+1 copë
- Radiolidhje për komunikim.....2 copë
- Bateri dore për ndriçim.....2 copë

4. Ekipi për ndihmë të parë medicinale
Zyrtari për ndihmë të parë :

Nr.	Emri dhe mbiemri	Nr.tel.fiks	Nr.celularit
1.	Floriant Pepshi		

Pajisjet e nevojshme:

- Uniforma për medikë..... palë,
- Maska mbrojtëse MC-1..... copë,
- Helmetacopë,
- Lese për bartjen e të lënduarëve..... copë,
- Çanta të kompletuara të ndihmës së parë..... copë,
- Komplete për imobilizim(fiksim)..... copë.

Përkujtues mbi procedurat me të lënduarit (ndihma e parë medicinale):

- Kontrolo vendin e ngjarjes,
- kontrolloje të lënduarin-aksidentuarin,
- Mos e lëvizë të lënduarin-aksidentuarin,
- Lëvizje të lënduarin nëse qëndrimi i tij aty nuk është i sigurtë,
- Lajmëro dhomën alarmuese(kujdestarinë),
- Kërko ndihmë prej ekipeve medicinale,
- Kujdesu për të deri në arrijtjen e ekipeve kompetente medicinale

5. Ekipi për intervenime teknike
Zyrtari për intervenime teknike:

Nr.	Emri dhe mbiemri	Nr.tel.fiks	Nr.celularit
1.	Avdyl Gacaferi		044246257

- Uniforma.....
- Helmeta.....
- Roba dhe mbathje gome të izoluara.....
- Garnitur veglave dhe çelësave.....

6. Përgjegjësit e kateve

Nr.	Emri dhe mbiemri	Kati	Nr.tel.fiks	Nr.celularit
1.	Avdyl Gacaferi	Kati përdhësë		044246257
2.	Arton Krasniqi	Kati I-ë		049760285
3.	Arian Xhuli	Kati II-ë		049516700

Komunikimi dhe ndërlidhjet

- Komunikimi për rrethë vendit të ngjarjes do të jetë: gojor, telefon, celular, radiolodhje, internet etj.,
- Çdo ekip intervenues duhet të ketë nga një radiolodhje për komunikim intern me postin komandues, edhe pse ende komuna jonë nuk ka radiolodhje në të ardhmen duhet të sigurohen.
- Komunikimi me emergjencat e qytetit dhe ato të nivelit Qendror do të bëhen përmes telefonit deri sa të vihet në funksion sistemi unik i 112.

Trajnimi i ekipeve

Trajnimet e ekipeve intervenente të emergjencave dhe të puntorëve bëhet në bazë të instruksioneve, planeve dhe programeve si :

- Plan-programi për aftësimin e punëtorëve në ndërtesë të Kuvendit nga lëmia e mbrojtjes kundër zjarrit,
- Planin-programin e ushtrimeve për pjesëtarët e ekipit të zjarrëfiksive dhe shpëtimit,
- Plan-programin për dhënjën e ndihmës së parë,
- Udhëzimi për mbrojtjen e objekteve (objektit) nga kurdisja e mjeteve zjarr-shpërthyes dhe mjeteve tjera eksplozive,
- Procedurës për evakuim,
- Procedurës në rast të fatkeqësive natyrore (tëmeteve, vërshimeve etj),
- Procedurës në rast zjarri,
- Procedurës për rastet e emergjencave luftarake.

Përfundim

Ky plan është i aplikueshëm dhe funksional vetëm nëse bëhet njoftimi dhe trajnimi i tërë personelit, ekipeve dhe personave përgjegjës të cilët do të caktohen dhe autorizohen për kryerjen e detyrave të veta, në situata emergjente.

Është e domosdoshme që menjëherë të caktohen personat përgjegjës, dhe të plotësohen pasqyrat e zbrazura për obliguesit në raste të emergjencave nga Zyrtarët e Sigurisë Civile në ndërtesën administrative të Kuvendit komunal.

Plani do të jetë i efektshëm vetëm nëse bëhet pajisja me mjete dhe trajnimi i ekipeve të shënuara në këtë Plan.

Komandanti i NJPZSH-së
Shkelzen Shehu




Emiratoj
Kryetari i Komunës Ruzhica Shehu